



Hapet thirrja për mobilitete studentësh dhe stafi të UPT-së,
në [Technische Hochschule Lübeck](#)

Në kuadër të programit Erasmus+ dhe marrëveshjes KA1 bilaterale, midis Universitetit Politeknik të Tiranës dhe Technische Hochschule Lübeck hapet thirrja për aplikime për studentët dhe stafin e Universitetit Politeknik të Tiranës, Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës, në Technische Hochschule Lübeck.

Lloji i mobilitetit përfshin: Pjesëmarrje në mobilitet një javor, të studentëve dhe stafit të Fakultetit të Arkitekturës dhe Urbanistikës.

Nivelet e mobilitetit për studentët: Studentët duhet të jenë të regjistruar në një program studimi në Fakultetin e Arkitekturës dhe Urbanistikës.

Koha e kryerjes së mobilitetit: Semestri i parë i vitit akademik 2026 – 2027, 13-19 dhjetor 2026 (5 ditë+2 udhëtim)

Numri total i studentëve: 20 studentë
Nga të cilët:
10 nga Dega e Arkitekturës, në vit të katërt të studimit
10 nga Dega e Urbanistikës, në vit të pestë të studimit

Dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët:

- CV;
- Kopje e Pasaportës;
- Vërtetim studenti;
- Listë notash e studimeve deri në momentin e aplikimit;
- Letër Motivimi (në gjuhën angleze);
- Çertifikatë e gjuhës së huaj, anglisht ose gjermanisht*;
- Dokumenti Learning Agreement**.

**Niveli minimal i kërkuar është B2. Studenti duhet të plotësojë nivelin minimal të kërkuar gjuhën duke e vërtetuar me çertifikatën përkatëse të gjuhës së huaj.*

***Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar programin që do të zhvillohet në universitetin pritës.*

Dokumenti “Learning Agreement” te seksioni “Commitment” firmoset nga aplikanti, nga Koordinatori Akademik i Fakultetit dhe nga Zv/Rektori i UPT-së për Anën Shkencore dhe Marrëdhëniet me Jashtë.

Afati për aplikim: Deri më 12 tetor 2026, ora 12.00

Aplikimi kryhet pranë Drejtorisë së Komunikimit dhe Koordinimit në UPT.

Për informacione shtesë në lidhje me procesin e aplikimit në UPT, mund të kontaktoni në e-mail: loretacapeli@gmail.com, abego@upt.al, rkodra@upt.al